POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 Atentati te kthesa e Rinasit, ja kush është viktima! I përfshirë në kultivimin e rreth 700 rrënjë kanabis në 2016

2 Trajneri: Florian Marku luftarak, por s'i arrin dot titujt kampion! Boksi shqiptar në hall, sportistët paguajnë për ndeshjet


3 Shqipëria fiton medalje argjendi, gjimnasti rus shkëlqen në kampionatin botëror

4 Brukselin apo Moskën? Vendos, zoti Vuçiç!

5 Alibeaj ankimoi vendimin e gjykatës për ndryshimet statutore, PD: Është i shkarkuar, nuk plotëson asnjë kriter legjitim për t'u ankuar

Kronikë

U vra dje brenda në makinë, viktimës i kishin borxh 1 mln dollarë, kishte një biznes kromi! Dëshmia e të vëllait: Ne si familje s'kemi hasmëri! Asnjë gëzhojë në vendin e ngjarjes

Një ekzekutim mafioz është kryer mbrëmjen e djeshme në rrugën dytësore Tiranë Durrës. Për pasojë i vdekur ka mbetur Iljaz Çali i cili gjet i pajetë në mjetin e marrë me qira. Dyshohet për të tjerë të plagosur, ndërsa policia po kryen kontrolle nëpër spitalet e vendit.

- Në 2014, në të njëjtën ditë, i vranë edhe shokun e ngushtë, dyshohej vrasës me pagesë
- Biznesmen kromi dhe vrasës me pagesë, kush ishte miku i ngushtë i i Iljaz Çalit i ekzekutuar 8 vite më parë
- E bërë 'shoshë' nga plumbat, ja makina ku u vra Iljaz Çali! Ekspertët marrin provat
- Ekzekutimi i Iljaz Çalit, autorët i dolën paralel dhe e qëlluan me kallashnikov
- Tiranë/ Ekzekutohet me armë zjarri brenda makinës një 37-vjeçar pranë kthesës së Rinasit! Dera e pasagjerit u gjet e hapur, dyshime se shënjestra nuk ka udhëtuar i vetëm (VIDEO)

Sokol Dema
4 Prill, 10:49 | Përditesimi i fundit: 4 Prill, 18:29

TIRANË- Ekzekutimi me armë zjarri brenda makinës së tij një ditë më parë e Iljaz Çalit mbetet ende e paqartë dhe e mjegull, ndërsa ende nuk ka autor për këtë krim. Report Tv ka zbuluar detaje të reja se Iljaz Çali kishte një biznesi kromi. 37-vjeçari rezultonte të kishte një biznes të përpunimit të kromit që prej janarit 2011, ku disponon 50 % të aksioneve në kompani Çali-Metal. Kompania ushtron aktivitet nga një zyrë në fshatin Nikël të Fushë-Krujës, dhe 50 për qind te aksioneve i zotëron i vëllai Zeqir Çali.

Një nga pistat e hetimit është pikërisht biznesi i tij, pasi referuar dëshmisë së vëllait të viktimës, Zeqir Çali ata si familje nuk kanë hasmëri me askënd, por u kanë borxh persona të tretë një shumë prej 1 mln dollarë. Në dëshminë e tij, ai përmend edhe një person me iniciale RR.D , ku thotë se 3 vite më parë u ka borxh 1 milionë dollarë për një person të 2400 tonëve krom.


LEXO EDHE:
Kishte valixhen plot me euro, por nuk i deklaroi, kapet 'mat' 26-vjeçari maqedonas në Rinas

> *"Ne si familje nuk kemi hasmëri, por një borxh që shtetasi RR.D na ka prej tre viteve në vlerën e tregut prej 1 milionë dollar për sasinë e 2400 tonëve krom", mësohet të ketë thënë vëllai.*

Koincidencë në këtë histori është se në të njëjtën ditë më 2 prill të 2014 atij i kanë varë mikun e ngushtë, ***Gjin Nika***, i cili gjithashtu kishte edhe një biznes kromi, ndërsa dyshohej se ishte edhe vrasës me pagesë. Pistat e hetimit për ekzekutimin e Iljaz Çalës janë ajo e larjes së hesapeve por edhe ajo e konfliktit për biznesin e kromit.

Iljaz Çali ka qenë duke lëvizur në autostradë në anën e shpejtësisë, ndërsa makina e autorëve i ka dal paralel dhe ka qëlluar me breshëri kallashnikovi. Mjeti 'Land Rover' që po udhëtonte Çali ka ecur për rreth 80 apo 100 metër dhe ka përplasur trafik-ndarësen. Report Tv mëson se vendin e ngjarjes nuk është gjetur asnjë gëzhojë dhe dosja ende nuk është referuar në prokurori. Fakti që nuk është gjetur ansjë gëzhojë tregon se autorët, që kanw qenë 2, drejtuesi dhe ekzekutori, kanë qëlluar nga brenda makinës duke mos lënë gjurmë në vendin e ngjarjes. Gjithashtu në makinën e viktimës 'Land Rover' nuk është gjetur armë apo sende të tjera të paligjshme.

Vrasja ndodhi mbrëmjen e djeshme pranë ***kthesës së Rinasit,*** ku Iljaz Çali, 37 vjeç u ekzekutua me armë zjarri teksa po lëvizte me mjetin e tip "Land Rover" me targa AB 988 AS.

Trupi i pajetë u gjet brenda mjetit i vetëm, por nuk përjashtohet mundësia që në mjet të këtë qenë edhe një person tjetër, për shkak se dera e pasagjerit ka qenë e hapur. Për këtë policia ka nisur hetimet dhe kontrollet në spitale për të plagosur. Iljaz Çali ishte besimtar mysliman dhe frekuentonte rregullisht xhaminë.

Grupi hetimor vijon të mbledh prova nga makina e viktimës për zbardhjen e plotë të ngjarjes dhe identifikimin e kapjen e autorëve.



MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
OKB

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L13705201P	
2. Data e Regjistrimit	05/01/2011	
3. Emri i Subjektit	ÇALI - METAL	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	04/01/2011	
6. Kohëzgjatja	Nga: 04/01/2011	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Durres Nikel RINAS Banese Private 1 kateshe, 200 m larg Aeroportit, Rinas	
8. Kapitali	100.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	100,00	
9. Objekti i aktivitetit	Shfrytezim dhe perpunim i mineralit te kromit, eksport i tij.Import-eksport, tregti me pakice dhe shumice te artikujve hidrosanitare, markete.Organizimi i transportit te udhetareve dhe mallrave me mjete te komunikacionit ajror, tokesor, detar, çelja e zyrave te agjencive turistik dhe te shitjes se biletave per udhetime brenda dhe jashte vendit.Ne fushen e tregtise, import-eksportit me shumice e pakice te mallrave industriale, ushqimore.Aktivitet ne fushen e ndertimit.Import-eksport te artikujve te ndryshem si dhe skrap etj.	
10. Administratori/ët	Iljaz Çali	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 04/01/2011	Deri: 04/01/2016
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	IljazÇali	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 50.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	50,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	
- *Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)*		

1

Kopje nga web



MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
OKB

13. Ortakët	ZeqirÇali	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 50.000,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	50,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	
- *Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)*		
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: ÇALI - METAL Telefon: 0692055929	
16. Statusi:	Aktiv	

Datë: 04/04/2022

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga web

Biznesi në emrin e tij

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 18:07

U vra dje brenda në makinë te kthesa e Rinasit, viktimës i kishin borxh 1 mln dollarë! Zbardhet dëshmia e të vëllait

Dëshmia e të vëllait të Iljaz Çalit, Zeqir Çali, do të shërbejë si një pistë e rëndësishme e hetimeve për ekzekutimin e të riut mbrëmjen e djeshme pranë kthesës së Rinasit. Në dëshminë përpara uniformave blu, ai është shprehur se nuk ka pasur asnjë hasmëri si familje, por përmend një borxh që i kanë persona të tretë që kap vlerën e 1 mln dollarë. Bëhet fjalë për një sasi të shitur prej 2400 tonëve krom nga biznesi që 2 vëllezërit disponoinin, "Çali-Metal".

> *"Ne si familje nuk kemi hasmëri, por një borxh që shtetasi RR.D na ka prej tre viteve në vlerën e tregut prej 1 milionë dollar për sasinë e 2400 tonëve krom", mësohet të ketë thënë vëllai.*

Ora 13:08

E bërë 'shoshë' nga plumbat, ja makina ku u vra Iljaz Çali! Ekspertët marrin provat



Në foto duket "Land Roveri" ku u vra mbrëmë Iliaz Çali mbrëmjen e djeshme në autostradën Tiranë-Durrës. Në fotot e publikuara nga LSA, shihen ekspertë të policisë teksa po kryejnë ekspertizat përkatëse mbi mjetin e bërë shoshë nga plumbat.

Me dorezë në duar dhe mjetet përkatëse, ata këqyrin makinën nga afër dhe marrin të dhënat e duhura. Automjeti është bërë 'shoshë' nga plumbat.

Ora 11:27

Biznesmen kromi dhe vrasës me pagesë, kush ishte miku i ngushtë i i Iljaz Çalit i ekzekutuar 8 vite më parë

Më 3 prill 2022 në kthesën e Rinasit u ekzekutua me kallashnikov Iljaz Çali, i cili kishte një biznes kromi. 8 vite më parë më 2 prill 2014, Çalit i ekzekutuan me 30 plumba mikun e ngushtë, Gjin Nika edhe ai me biznes kromi, ndërsa dyshohej si vrasës me pagës dhe autorë i shumë krimeve të rënda. Nika u vra në Urën e Tapizës në Fushë Krujë vetëm një javë pasi ishtë liruar nga burgu.

Gjin Nika dyshohej edhe si vrasës me pagesë dhe autori i ekzekutimit të biznesmenit të kromit, Hasan Talja. Emri i Gjin Nikës ka qenë edhe në listën e të dyshuarve për vrasjen e Shefqet Shehut në vitin 2013 në Bulqizë, ndërsa për të ka patur vetëm një dënim me 1 vit burg për plagosjen e Shkëlqim Shehut, vëllai i Shefqetit dhe falsifikim dokumentesh. Të gjitha vrasjet dyshohet se janë kryer për shkak të konflikteve në lidhje me menaxhimin e minierave të kromit në Bulqizë.

Ora 11:09

Ekzekutimi i Iljaz Çalit, autorët i dolën paralel dhe e qëlluan me kallashnikov

Iljaz Çali

Report Tv mëson se Iljaz Çali ka qenë duke lëvizur në autostradë në anën e shpejtësisë. Makina e autorëve i ka dal paralel dhe ka qëlluar me breshëri kallashnikovi.

Mjeti 'Land Rover' që po udhëtonte Çali ka ecur për rreth 80 apo 100 metër dhe ka përplasur trafik-ndarësen. Viktima po shkonte në shtëpi në Rinas të Ri kur u qëllua, ndërsa akoma është e paqartë ku kishte qenë gjatë darkës.

Makina e autorëve dyshohet se është larguar drejt Fushë Krujës, ndërsa asnjë gëzhojë nuk është gjetur në vendin e ngjarjes, ku autorët kanë qëlluar nga brenda mjetit pa lënë prova.

I.K./B.K./Shqiptarja.com

TAG: gjin nika Tirane iljaz cali atentat vrasja e iljaz calit

Komento

Komente

Zdroms: 04/04/2022 18:39
Ore nqs ka qen killer me pages pse i jepni kaq rendesi.nje kerrm me pak!
Përgjigju

SKUBI: 04/04/2022 15:48
Altin Lamaj eshte nje Byth push legen bastard qe ka frik veten e vet.
Përgjigju

Per hasten: 04/04/2022 17:13
Kush esht krahu I djatht I altinit??? Altini mall qe ka doqen qe po mbaron pun me shoket e milit mall qe ka çamin e vlores qe po ja qeron hasmet altini nipi vaidinit doqja kunati Festes Festa esht vllai didit vlores didi me vajdinin ishin super miq per te gjith ju qe se dini mini u be me harizajn sepse kishin hasmet miq tori daja I harizajt hasmi didit mili me dajtin hasmet e vajdinit kaq

Hasta: 04/04/2022 16:50
O vella altini ka lekun e kush ka lekun ben cte doje , i shkaterroi me shtet milin me shok e tani do kalben ne burg , kurse krahu i djatht i tij nuk eshte ky eshte ai qe vrau 4 veta pernjeher e ishte me birgim te perjetshem po pagoj leket altini e e liroj, e vertet se jet qenit bejn te gjithe keto duke u msheh por cunat e parkut i mundi ky , ata jan thjesht pjese 3 historise na ishte nje here

Juvenilja: 04/04/2022 13:01
Krahu i djatht i altin lamajt
Përgjigju

Ik o pall: 04/04/2022 15:37
A e di kush esht altin lamaj ? As ska shans ti afrohen njerz te till jo me te jet krahu djathet

eri: 04/04/2022 14:08
kush esht krahu djatht i altinit ky qe u vra ? edhe altinit te paprekshem filluan dukenja vrare shoket hajde hajde

Trump: 04/04/2022 12:44
Biznesmen tjetri, jo shaka, ketej vuuu fallcifikimet dhe vrasjet. Pse nuk heton shteti si i kane marre ne pronësi minierat keta trimat? Shtet leshi.
Përgjigju

Qobani: 04/04/2022 12:40
Pse vlla po na shkon jeta me ngushllime,athua si ashtë turpi i Kombit,me jabanxhi kurrë su koritum mes veti shum trima!?
Përgjigju

Loni: 04/04/2022 11:58
Vetem njeri eshte kreu I minierave te kro it asnje tjeter... Te tjeret Jan leckamane bastarde qe hahen me njeri tjetrin ai rri si pasha ne tirane!
Përgjigju

Ceco me bicak: 04/04/2022 11:49
Cdo te mbjellesh do te korresh ngushullime familjes
Përgjigju

vlora1: 04/04/2022 11:42
Po nga e gjeti ky minieren e kromit ,ja fali babai apo mamaja.Shpejt a vone te gjithe keta atje do vene do gjejne njeri tjetrin
Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A mund ta fitojë Ukraina luftën ndaj Rusisë?
PO JO NUK E DI

Lajme të tjera

Sociale

Tiranës i shtohen edhe dy terrene sportive, fushë e re basketbolli dhe volejbolli në bllokun 'Shefqet Musaraj'
4 Prill, 14:13

Sociale

Veliaj me mësuesit dhe nxënësit në gjimnazin e rindërtuar "Sami Frashëri": Shkollën e përurojmë këtë vit në shtator
4 Prill, 13:56

Kronikë

Blinin kartëmonedha false në rrjetet sociale dhe i hidhnin në qarkullim, pranga 5 adoleshentëve në Tiranë
4 Prill, 13:45

Kronikë

Ekzekutimi i Iljaz Çalit, eksperti i kriminalistikës: Autorët nuk dogjën automjetin, kanë përfituar nga errësira! Stakimi i energjisë si masë kursimi i nxituar, do nxisë kriminalitetin
4 Prill, 13:02

Politikë

Vakanca nga dorëheqja e Alqi Bllakos, KQZ i jep zyrtarisht mandatin Pandeli Majko
4 Prill, 10:52

Sociale

Banorët e 5 Majit dhe Laprakës protestë para Bashkisë Tiranë: Kërkojmë bisedime me Veliajn, nuk do lejojmë të ndërtohet mbi pronat tona
4 Prill, 10:32

Kronikë

Tiranë/ Ekzekutohet me armë zjarri brenda makinës një 37-vjeçar pranë kthesës së Rinasit! Dera e pasagjerit u gjet e hapur, dyshime se shënjestra nuk ka udhëtuar i vetëm (VIDEO)
3 Prill, 22:44

Politikë

Veliaj pret kryebashkiakun e Mykonos: Mundësi për të mësuar nga më të mirët në turizëm
3 Prill, 20:44

Analiza

'Maloklliku' si paragjykim apo si fizolofi politike!
Alban Daci
3 Prill, 16:37

Politikë

Konferenca Ballkanike e Lidershipit, Veliaj: Presidenti i ri? Do ta doja një njeri në shërbim të njerëzve, si Moisiu
3 Prill, 11:24

Kronikë

Maskohej me kapuç për t'u mos u identifikuar, kapet 'mat' hajduti i mitur profesionist në Tiranë! Vidhte markete, automjete dhe banesa
3 Prill, 10:19

Sociale

Sot në të gjithë vendin 'Dita pa makina', rrugët ku do të kufizohet qarkullimi i automjeteve në disa qytete
3 Prill, 07:04

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje